

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | VIDEO/ "Paraja nuk është vlerë", regjisori Kriks Dumo: Dëshira për sukses dhe kurthi i parave të shpejta                                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/kulture/paraja-nuk-eshte-vlere-regjisori-kriks-dumo-deshira-per-sukses-dhe-kurth-i588751">https://www.gazetatema.net/kulture/paraja-nuk-eshte-vlere-regjisori-kriks-dumo-deshira-per-sukses-dhe-kurth-i588751</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 27 shtator 2026, 14:22:12 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 15:00:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 5cf04b82ee00d13f3f6b5efd54b0f4e2c13bb4505154f5d5678d8ab532705b1a |
| TEKSTI     | 3e53fea8019a8b0c26acbc0a2a1413d38b39855ec35bcd126e5bff20272f4c5b |
| PAMJA      | ebb609be7f0d2eaa23fb0b7bb168a0ecab165770e14206c87d817ab1662e32e7 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 5757f1ef0add86e57bb28396c64bf6c28c5ea902fa259462d667b36d608cd6c1                                |
| E MËPARSHMJA  | 263131ce49e7b6ae7164e97b0656b1bebda8cc0026c5756c896751cc76f49dd3                                |
| RRËNJA MERKLE | 3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5757f1ef0add86e57bb28396c64bf6c28c5ea902fa259462d667b36d608cd6c1>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie Kina "merr timonin" ne tregun e veturave elektrike ne KosoveKeshilli i Marredhenieje Shqiptaro-Amerikane mbledh ne Nju Jork drejtues politike dhe pertaqesues te dia fundit

## VIDEO/ “Paraja nuk është vlerë”, regjisori Kriks Dumo: Dëshira për sukses dhe kurthi i parave të shpejta



27 Shtator 2026, 17:00Kulturë TEMA




Nëse ka një ndjesi që i përkufizon më së miri kohërat në të cilat jetojmë, është dëshira për t'ia dalë mbanë me çdo kusht dhe që bota të na e njohë suksesin tonë, cilido qoftë ai. Në të shumtën e rasteve kjo merr formën e dëshirës për t'u pasuruar sa më shpejt; ndonjëherë merr formën e rendjes drejt suksesit apo famëms. Mundësitë për t'i arritur të gjitha këto, të paktën në teori, janë kudo. Cilido mund të krijojë sot një audiencë të vetën, të ndërtojë një karrierë të sukseshme bazuar tek talenti dhe të jetë dikushi. Rrjetet sociale na japin modelet dhe provën e kësaj, por ajo që nuk para e shohim është çfarë vjen para gjithë kësaj: paratë, njohjet, dështimet apo edhe fati që e bëjnë të mundur suksesin. Shohim vetëm rezultatin dhe matemi me të, sikur të gjithë ta nisnim jetën nga e njëjta pikë.

Është ky padurim për sukses dhe pasuri që e përshkon “Koka e Kolës,” filmin e parë me metrazh të gjatë të regjisorit të ri Kriks Dumo, i cili më bashkohet në këtë episod të Apostrof. Një film që bën bashkë komedinë, aksionin dhe dramën për të treguar historië e një të riu, përpjekjet e të cilit për t'ia dalë në krye jetës, e tërheqin drejt botës së krimit dhe përballjeve gjithnjë e më të rrezikshme. Sokoli (Kola) nuk e ka guximin e nevojshëm për të përballuar botën në të cilën kërkon të hyjë, por është mjaftueshëm kokëkrisur sa të mendojë që mund t'ua hedhë të gjithëve. Siç thotë edhe vetë Dumo, personazhi i tij ka dështuar në çdo përpjekje për t'ia dalë mbanë në mënyrë të ndershme. Paratë janë e vetmja gjë që i premtajnë një mundësi për t'u arratisur nga zhgënjimet e njëpasnjëshme, edhe pse nuk e ka idenë se çfarë do të bënte me to, apo se çfarë njeriu do të bëhej në momentin që do t'i siguronte ato.

Dumo përdor komedinë për ta tërhequr publikun brenda kësaj bote, para se ta vendosë atë përballë pasojave. Ai e lidh vendimin e tij për ta mbajtur pjesën më të madhe të dhunës jashtë ekranit me distancën që të gjithë ne kemi ndaj brutalitetit për të cilin dëgjojmë në lajme. Biseda kthehet gjithashtu tek kuptimi i parësë sot. “Të thuash ‘kam para’ nuk është vlerë,” thotë Dumo. Siguria financiare është e rëndësishme, por dilema është se përse pasuria duhet parë si provë e vlerës së dikujt, ndërkohë që mënyra se si ajo është arritur nuk merr të njëjtën vëmendje.

Realizimi i filmit ka kërkuar një durim që protagonistit të tij, qartësisht i mungon. Duke punuar me një buxhet të vogël dhe ndihmë praktike nga bashkëpunëtorët e tij, Dumo thotë se ka zgjedhur të marrë më shumë kohë për realizimin e tij, në mënyrë që të arrinte rezultatin që donte. Ai thotë gjithashtu se gjatë xhirimeve i është dashur ta ndajë kohën mes setit dhe spitalit, ku babai i tij po operohej. Këto detaje e rikthejnë bisedën tek puna që zakonisht e shohim në imazhin

përfundimtar të suksesit. Pas një filmi për arritjen e suksesit të shpejtë, fshihet një proces dhe punë më e ngadaltë për arritjen e rezultateve dhe për të vazhduar edhe kur nuk je gjithmonë i sigurtë se do të shpërblehesh në fund.



 Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

Gonxhja: Do ruhet identiteti karakteristik i Vunoit

15:48 Kulturë

## [Shqipëria mirëpret Javën Kulturore Kroate \(VIDEO\)](#)

13:46 Kulturë

## [Kori BujArt këndon në Berlin](#)

11:44 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.